



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:162342

Datë: 09.02.2024

Numri i dokumentit: 05307987

Ac.nr.5675/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Naime Ahmeti kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Adnan Konushevci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B..... K..... e S..... (BKS) nga Prishtina, Rr. “L..... e P....”, p.nr, kundër të paditurit I.M., nga fshati Ll..... e E....., Komuna e Podujevës, me bazë juridike rimbursim dëmi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, C.nr.514/2017 të datës 06.04.2021, në seancën e kolegjit e mbajtur me datë 06.02.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet e themeltë ankesa të paditurit I.M., nga fshati Ll..... e E....., Komuna Podujevë, prishet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, C.nr.514/2017 i datës 06.04.2021, dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, C.nr.514/17 të datës 06.04.2021, ka aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadinë e paditëses B..... K..... e S.....e (BKS) nga Prishtina, Rr. “L..... e P....”, pn, dhe ka detyruar të paditurin I.S.M., nga fshati Ll..... e E....., Komuna e Podujevës, që paditëses t’ia kompensoj shumën prej 786.00 euro, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar të dëmtuarës H.B., në aksidentin e trafikut të datës 02.10.2014 në Podujevë, me kamatë ligjore të cilën e paguajnë B.... K..... në Kosovë, për mjetet e deponuara në afat mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 20 euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë i padituri, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të

gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën ta aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj duke refuzuar kërkesëpadinë e paditëses ose aktgjykimin ta anuloj dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosije.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e themeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, me padinë e parashtruar në gjykatën e shkallës së parë, ka kërkuar që të detyrohet i padituri për rimbursimin e dëmit, në shumë prej 786.00 euro, lidhur me rastin e aksidentit të ndodhur në trafik me datën 02.10.2014, në Podujevë.

Duke vepruar sipas padisë, pas pranimit të përgjigjes në padi gjykata e shkallës së parë ka vendosur për aprovimin e kërkesëpadisë, konform dispozitës së nenit 152 të LPK-së, duke marr aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes. Gjykata e shkallës së parë, bazën e kërkesëpadisë e ka vërtetuar nga shkresat e lëndës duke u bazuar kështu në dispozitën e nenit 18 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, dhe neneve 8, 245 të LMD-së, sa i përket kamatës ka vendosur konform nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës e ka arsyetuar me nenet 449 dhe 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1, lidhur me nenin 152 të LPK-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duke vendosur si në dispozitivin e aktgjykimin të atakuar ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1, lidhur me nenin 152 të LPK-së. Në bazë të nenit 152 të LPK-së, është paraparë që aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes mund të nxjerrët nga gjykata: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”* Si kusht elementar për nxjerrjen e aktgjykimin pa shqyrtim kryesor të çështjes është që pala e paditur t'i pohoj faktet e prezantuara nga pala paditëse. Në rastin konkret i padituri me përgjigje në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses sa i përket shkaktimit të aksidentit si dhe lartësisë së kompensimit, nga çka rezulton se nuk janë plotësuar kushtet për të nxjerrë aktgjykimin pa shqyrtim kryesor të çështjes. Për arsyet e cekura si më lartë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë u deshtë që të prishet në tërësi dhe lënda të kthehet në rivendosije.

Në riprocedurë, gjykata e shkallës së parë duhet që t'i eliminojë shkeljet e konstatuara si më lartë, të caktoj shqyrtim lidhur me kërkesëpadinë e paditëses, duke ftuar në mënyrë të rregullt palët ndërgjyqës, ashtu që palëve në procedurë t'iu jepet mundësia e shqyrtimit të çështjes në

gjykatë dhe pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor të çështjes, të bëj administrimin e provave të paraqitura nga palët dhe varësisht nga provat e prezantuara të nxjerr vendim të drejtë dhe të ligjshëm duke dhënë arsyetim të mjaftueshëm në pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura më lart e në pajtim me nenin 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (c) të LPK-së, u vendos si në dispozitivi të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.5675/2021, me datë 06.02.2024

Kryetare e Kolegjit  
Naime Ahmeti